



KONTRATA SOCIALE SHKODËR

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

SHTATOR2020 - SHTATOR2021

Viti i II-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESË



POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Shtator 2020 – Shtator 2021

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Ky raport është përgatitur nga organizata “Intelektualët e rinj, Shpresë” në kuadër të projektit POP “Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi e vetëm autorëve, organizatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”.

Tabela Përmbledhëse

| | |
|--|-----------|
| Falenderime | 5 |
| HYRJE | 6 |
| Procesi i formulimit të prioriteteve të kontratës sociale | 7 |
| 1. Gjetje nga viti i parë i monitorimit, gusht 2019- gusht 2020..... | 8 |
| 2. Viti dyte i monitorimit, periudha shtator 2020 - shtator 2021..... | 9 |
| 3. Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale | 10 |
| Rekomandime..... | 19 |

Falenderime

Për të hartuar këtë raport bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Shkodër, dhe drejtoritë përkatëse për përgjigjet e shpejta brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Shkodër, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe një vjeçare. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë *Olof Palme International Center* dhe *NED – National Endowment for Democracy* për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

HYRJE

Në vitin 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "*Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)*" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Bashkia Shkodër nuk e ka nënshkruar si dokument por është njohur me të.

Gjatë vitit 2020 projekti ka vijuar me "*Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.*" Në vitin e parë të monitorimit të Kontratës Sociale është krijuar raporti për periudhën Gusht 2019 – Gusht 2020, i cili vlerëson progresin e bërë për realizimin e prioritetëve të kontratës sociale. Në bazë të monitorimit të Bashkisë Shkodër, të kryer nga "*Intelektualët e Rinj, Shpresë*" (IRSH), në raport janë paraqitur gjetjet dhe rekomandimet.

Po ashtu, në vitin 2021 projekti ka vijuar sërish me përpilimin e raportit të dytë për "*Monitorimin e zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal*". Ky raport vlerëson progresin e bërë për realizimin e prioritetëve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe IRSH në kuadër të nismës POP synon që të llobojë dhe të advokojë për prioritetet e qytetarëve.

Pandemia Covid – 19 edhe në këtë periudhë ka vijuar të impaktojë jetën sociale, aktivitetin e njerëzve, familjeve dhe bizneseve por edhe atë të institucioneve vendore.

Gjatë muajve Shtator 2020 – Shtator 2021 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve, veçanërisht çështjet që lidhen me të rinjtë, si infrastruktura arsimore apo punësimi rinor.

Metodologjia

Për të realizuar raportin IRSH, pjesë e rrjetit POP u bazua në hapat si më poshtë:

- Monitorimi i punës së bashkisë Shkodër dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën shtator 2020 – shtator 2021;
- Shkëmbim informacioni nëpërmjet kërkesës për informim me Bashkinë Shkodër, bazuar në prioritetet e Kontratës Sociale;

- Analizë dhe monitorim i vendimeve të Këshillit Bashkiak Shkodër që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale;
- Realizimi i fokus grupeve me qytetarët në lidhje me përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara në Kontratën Sociale;
- Analizë dhe monitorim i mediave sociale të Bashkisë Shkodër dhe Këshillit Bashkiak;
- Monitorim i mediave lokale

Procesi i formulimit të prioriteteve të kontratës sociale

Për identifikimin e prioriteteve të komunitetit për Bashkinë Shkodër në mars 2019 u zhvilluan 6 forume me banorë të rajoneve të qytetit të Shkodrës, Bërdicës, Gurit të Zi, Dajçit dhe Postribës. Në forume u diskutuan 22 çështje me interes për komunitetet lokale, si dhe u identifikuan prioritetet në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej forumeve u përfshinë qytetarë të grup - moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Publikimi i prioriteteve të kontratës sociale

Çështjet e diskutuara në forumet civile janë përfshirë në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Zhvillimi ekonomik vendor
2. Shërbimet publike
3. Dimensionin social
4. Demokracia vendore

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u ndanë në dy grupe:

1. **Ndërrhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërrhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;

Pas diskutimeve u formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti, 26 prioritetet.

1. Gjetje nga viti i parë i monitorimit, gusht 2019- gusht 2020

- 1.1** Këshilli i Bashkisë Shkodër ka miratuar aktet e nevojshme për miratimin e AMTP-ve (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), për personat që kanë përfutur me ligjin 7501, datë 19.07 1991. Ky proces pritet t'i japë fund procesit të regjistrimit fillestar të tokave. Ky proces do të realizohet gjithashtu edhe për pronat shtetërore në administrim të Bashkisë Shkodër.
- 1.2** Procesi i konsultimit për miratimin e planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 për shkak të pandemisë Covid 19 u pezullua për shkak të pamundësisë për të realizuar dëgjesa publike me numër të lartë të banorëve. Në këto kushte në Bashkinë Shkodër marrja e mendimit të qytetarëve në lidhje me procesin e konsultimit të draftit të Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 bëhet nëpërmjet një ankete e cila aksesohet online. Në këtë mënyre qytetarët mund të shprehin mendimet e tyre deri me datën 5 tetor 2020.
- 1.3** Për banesat sociale në Bashkinë Shkodër kanë aplikuar rreth 250 qytetarë. Nevojat janë të mëdha dhe parashikohet të shpërndahen edhe 100 kredi të buta për të ndihmuar qytetarët në lidhje me strehimin social.
- 1.4** Minoriteti rom do të jetë përfutur i 27 banesave sociale që po ndërtohen dhe pritet të jenë të gatshme deri në fund të vitit 2020.
- 1.5** Ndërtimi i fushave sportive të shkollës “Gjergj Vat Martini”, Njësia Administrative Velipojë është një investim i Bashkisë Shkodër që plotëson një nga kërkesat e të rinjve të kësaj zone.
- 1.6** Këshilli Bashkiak ka miratuar akte të rëndësishme vendim nr.19 datë 23.04.2020 për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 të Bashkisë Shkodër dhe vendim nr.26 datë 30.12.2019 për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë së Shkodrës si dhe paketën fiskale të 2020.
- 1.7** Kush ndot më shumë, paguan më shumë: diferencohet taksa e pastrimit sipas llojit të biznesit.
- 1.8** Diferencim i tarifës së ndriçimit sipas dendësisë së popullsisë dhe fluksit të vizitorëve.
- 1.9** Bashkia Shkodër ka vijuar shpenzimet në bazë të buxhetit për vitin 2020, në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në transparencën e buxhetit rezulton se 43% është përqindja e realizimit të buxhetit të vitit 2020. Kjo llogaritje është për 7 mujorin e parë të 2020.

2. Viti dyte i monitorimit, periudha Shtator 2020 - Shtator 2021

Gjetjet nga informacioni i mbledhur për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021, në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale:

- 2.1 Bashkia Shkodër në lidhje me “nxitjen e bizneseve te të rinjtë” prioritet nr.1 dhe nr.2, ka luajtur një rol të rëndësishëm koordinues për nxitje e bashkëpunimit me donatorë në kuadër të thirrjeve për grante mbështetëse për bizneset e reja si dhe rritje të kapaciteteve. Po ashtu, inkubatori i biznesit është hapur gjatë kësaj periudhe për të gjithë të interesuarit.
- 2.2 Prioritet nr.15 mbi procesin e konsultimit me qytetarët për projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022 – 2024 , Bashkia Shkodër e ka realizuar me anë të:
 - a) rreth 15 dëgjësive publike me komunitetin.
 - b) Sondazhit online ku qytetarët kanë patur mundësi për të shprehur mendimin e tyre në mënyrë që ky proces të jetë sa më gjithëpërfshirës.
- 2.3 Lidhur me prioritetet nr.6 dhe nr.25 të Kontratës sociale, Bashkia Shkodër ka kryer ndërhyrje për mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe ngrohjen në shkolla, kopshte, çerdhe në qytetin e Shkodrës apo Njësitë Administrative.
- 2.4 Këshilli bashkiak miratoi sistemin e pikëzimit për programin e strehimit social të “Banesave sociale me qera” si dhe “Subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit” nëpërmjet VKB nr.12 datë 26.02.2021 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2021”.
 - a) Nga familjet që kanë jetuar në banesa jashtë standarteve të përcaktuara në ligj, në rrezik shembje apo që nuk mund të kualifikohen si banesa, janë 20 familje që kanë përfituar nga programet e strehimit social.
 - b) Janë planifikuar 100 kuota për programin e subvencionimit të interesave të kredisë.
- 2.5 Në lidhje me prioritetin nr.5 për organizimin e shërbimit të transportit publik, aktualisht janë në funksion dy linja të transportit publik qytetas. Megjithatë, transporti publik vijon të mbetet një shqetësim, pasi ky shërbim duhet të përmirësohet në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe studentëve.
- 2.6 Ndërsa, përsa i përket fushës së dimensionit social lidhur me prioritetin nr.19 dhe nr.20, mbi shërbimet që ofrohen për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje mësohet se; Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2020 dhe periudhës Janar - Shtator 2021 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 221 raste të dhunës në familje. Problematikat e dhunës në familje janë shtuar më shumë për shkak të periudhës së Covid – 19. Strehim social kanë përfituar 8 gra viktime të dhunës në familje.
- 2.7 Bashkia Shkodër po zbaton programin e strehimit social për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom ku do të përfitojnë 27 familje të këtij komuniteti.
- 2.8 Prioriteti nr.23 mbi “mundësitë e komunitetit për ta marrë informacionin dhe që mundësojnë transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak”, çdo

qytetarë mund të aksesojë lehtësisht informacionin e kërkuar në faqen web të Bashkisë Shkodër apo rrjetet sociale të tyre.

- a) Këshilli Bashkiak gjatë kësaj periudhe ka vijuar punën normalisht duke u mbledhur *të paktën një herë në muaj*.
- b) Disa nga mbledhjet janë *zhvilluar online* për shkak të pandemisë. Pasqyrimi i tyre ka qenë nëpërmjet:
 - 1) publikimit në rrjetin social Facebook të Këshillit Bashkiak.
 - 2) transmetimit të drejtëpërdrejtë nga salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në mediat lokale.

3. Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale:

Nga komunikimet zyrtare dhe monitorimi i dokumentave zyrtare rezulton:

Prioritet 1. *Krijimi i inkubatorëve të biznesit si zona pa taksa për të rinjtë që kanë ide kreative dhe novatore në zhvillimin e biznesit.*

Inkubatori i biznesit për të rinjtë është një hapësirë e krijuar në Qendrën Rinore Atelie, i cili në vitin e parë të monitorimit ishte jo funksionale për shkak të fondeve.

Nga komunikimi me Bashkinë Shkodër mësohet se, bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër jep asistencën e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte që kanë nevojë si dhe i mban të informuar ato për thirrje të ndryshme që hapen gjatë vitit.

Prioritet 2. *Krijimi i incentivave mbështetëse nëpërmjet programeve të specializuara për mbështetje financiare për startup-et rinore.*

Bashkia Shkodër ka luajtur një rol të rëndësishëm koordinues për nxitjen e bashkëpunimit me donatorë në kuadër të thirrjeve për grante mbështetëse për bizneset e reja si dhe rritje të kapaciteteve. Përfshirja në projektet si: “IDEA”, “Dimak”, “Uplift – Startup accelerator program”, “EU Challenge for Innovation” etj, ka krijuar mundësi të mira për të rinjtë dhe të gjithë të interesuarit për të pasur rritje të kapaciteteve të tyre si dhe mbështetje financiare.

Prioritet 3. *Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të çertifikimit të pronësisë mbi tokën.*

Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, stafi i bashkisë Shkodër asiston fermerët në plotësimin e dokumentacionit për aplikim të marrjes së mbështetjes financiare përmes granteve apo subvencioneve.

Vendim nr.1 datë 22.1.2020 “Për miratimin në parim të ngritjes së komisionit të përkohshme (ad-hoc) për verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjore të procesit të “AMTP”.

Për të përfunduar procesin e regjistrimit në kadastër të titujve të pronësisë (AMTP) të përfiturar më ligjin 7501, datë 19.07 1991, verifikimi i dokumentacionit realizohet si më poshtë:

- Ana e Malit / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 204 dosje.
- Velipojë / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 762 dosje.
- Postrisë / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 2391 dosje.
- Rrethina / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 1216 dosje.
- Bërdicë / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 1387 dosje.
- Dajç / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 786 dosje
- Guri i Zi / Përpunimi dhe përcjellja e dokumentacioneve të pronësisë për çertifikim 638 dosje.

Prioritet 6. *Mirëmbajtja e shkollave egzistuese dhe plotësimi me mjete didaktike.* Me prioritet investime në shkollën e njësisë administrative Dajç për shkak të gjendjes shumë të keqe të saj. Në lidhje me këtë prioritet Bashkia Shkodër ka kryer ndërhyrje në rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e disa shkollave në qytet dhe njësitë administrative.

Lagjia nr.1

- Rikonstruksion i ambienteve të katit përdhe shkolla “Shejnaze Juka”
- Instalim i kaldajës në shkollën “Ismail Qemali”

Lagjia nr.2

- Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës “Azem Hajdari”
- Vendosje e rrjetës rrethuese në ambientet sportive shkolla “Oso Kuka”

Lagjia nr.3

- Rikonstruksion i shkollës “Jordan Misja” faza I+II
- Rikonstruksion i tarracës shkolla “Prek Jakova”

Lagjia nr.4

- Rikonstruksion i shkollës “Kol Idromeno”
- Instalim i kaldajës shkolla “Martin Camaj”

Njësia Administrative Bërdicë

- Punime për mirëmbajtjen e çatisë shkolla “Frederik Gjoni”

Njësia Administrative Dajç

- Punime dhe mirëmbajtjen e katit përdhe të shkollës “Luçe Agraja”

Njësia Administrative Guri i Zi

- Në proces punime për mirëmbajtjen e shkollave “At Gjon Karma” dhe “Zef Jubani”
- Instalim i kaldajës së shkollës 9- vjeçare “Arif Selimi” Vukatanë

Njësia Administrative Postrinë

• Rikonstruksion i çatisë shkolla “Mes Myselim” dhe ambienteve shkolla Domën Ndërsa, përsa i përket shërbimit të ngrohjes në shkolla ofrohet nga Bashkia Shkodër, për arsimin bazë parashkollor dhe atë të mesëm. Shërbimi i ngrohjes ofrohet për një periudhë 4 mujore, fillon me datë 15 Nëntor dhe përfundon me datë 15 Mars.

- Në vitin 2021 numri i shkollave që ngrohen me kaldajë është 11 nga të cilat 10 shkolla në qytet dhe 1 në NJA.
- Numri i shkollave të cilat ngrohen me gaz të lëngshëm është 16, nga të cilat 11 shkolla në qytet dhe 5 në NJA.
- Numri i shkollave të cilat ngrohen me dru zjarri janë 55, nga të cilat 5 shkolla në qytet dhe 50 në NJA.

Prioritet 7. Përmirësim i ndriçimit në qytetin e Shkodrës dhe njësitë administrative Bërdicë, Gur i Zi, Dajç dhe Postrinë.

Lagjia nr.3 - Ndriçimi i rrugës “Amadeo” ; Ndriçimi i rrugës “Margjoni”

Lagjia nr.4 - Ndriçimi i rrugës “Visho Begu”; Ndriçim i bulevardit “Mehmet Pashë Plaku”; Ndriçimi i rrugës “Koplikej”

Dajç - Ndriçimi i rrugës Darragjat; rruga fshati Suka zona urbane; rruga e fshatit Pentar

Guri i Zi - Ndriçimi i fshatit Rrencë, Ndriçim i lagjes Kasape ; ndriçimi i lagjes Grenas; Ndriçim i fshatit Vukatanë

Rrethina - Ndriçimi i rrugës Hamidije fshati Shtoj i Vjetër; rruga Hysaj - fshati Golem; rruga e Ftonjve - Guci e Re; rruga Kaskada - Grudë e Re; rruga Fangaj – Bardhaj

Gjithashtu, janë në proces përfundimi për ndriçimin e disa rrugëve në Velipojë dhe në njësinë administrative Postrinë.

Prioritet nr.8 lidhet me “përmirësim i cilësisë së pastrimit dhe shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave në qytetin e Shkodrës dhe njësitë administrative”, ku bashkia Shkodër ka raportuar se është shtuar shërbimi dhe strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontinierë shtesë edhe në të gjitha Njësitë Administrative.¹

Gjatë vitit 2021 vazhdohet me kontratat e reja për të gjitha njësitë administrative në dy zona funksionale respektivisht për zonën Perëndimore njësitë Velipojë, Dajç, Bërdicë, Ana e Malit dhe për zonën lindore, njësitë administrative Rrethina, Postrinë dhe Gur i Zi. Procedurat këto të

¹ <https://bit.ly/3IPf4kS>

realizuara në zbatim të detyrimit ligjor sipas zbatimit të detyrimit ligjor për një menaxhim të drejtë, transparent dhe me efikasitet financiar në përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të sektorit të mbetjeve me zbatimin e VKM 319/2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së performancës dhe standartit të shërbimit përmes përmirësimit teknologjik, të rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe penaltiteve.

Prioritet 10. Pastrim dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e kanaleve kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative Bërdicë, Gur i Zi, Dajç dhe Postribë.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave duke qënë një nga prioritetet e Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë, mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2021² dhe me hartimin e projekteve teknike është arritur të realizohet për pastrimin e 92 km kanale kulluese. Këto ndërhyrje kanë sjellë përmirësimin e një sipërfaqeje toke bujqësore me kullim të përmirësuar prej 2270 Ha.

Përsa i përket rrjetit ujitës është arritur për periudhën të mirëmbahen 10.5 km kanale ujitës me një sipërfaqe të përmirësuar ujitjeje prej 710 Ha.



Fig. nr.1 për pastrimin e kanaleve kulluese³

Prioritet 11. Përmirësim i furnizimit me ujë të pijshëm dhe cilësisë së ujit.

Bashkia Shkodër dhe territori i bashkisë ka veçori të shumta për sa i përket rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve duke marrë parasysh shtrirjen territoriale që ka. Këto veçori territoriale kërkojnë studime dhe plane të detajuara për ndërhyrjet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e rrjetit. Për implementimin e projekteve për infrastrukturën e ujësjellësit bashkia bashkëpunon me partnerë të rëndësishëm si KFW dhe SECO.

Këtë vit janë në realizim projektet si më poshtë:

- Programi i performancës në sektorin Ujësjellës - Kanalizime me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit Europian dhe SECO

² <https://bit.ly/3EGPQfN>

³ <https://bit.ly/3ybvBEC>

- Ndërtimi i ujësjetillësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër
- Rikonstruksion i rrjetit kryesor të ujësjetillësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjetillësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i ri, Shtoj i vjetër, Vinoteka dhe Fshati Ri(Pularia).

Prioritet 13. *Vijimi i investimeve dhe ndërhyrjeve që përmirësojnë infrastrukturën.*

Gjatë këtij viti Bashkia Shkodër ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi; ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore. Në lidhje me këtë prioritet janë bërë hapa pozitiv pasi janë kryer investime në rrugë kryesore dhe dytësore të lagjeve të qytetit . Gjithashtu, janë duke u kryer ndërhyrje të tjera për mirëmbajtjen, sistemimin apo asfaltimin e rrugëve të cilat janë akoma në proces.

- Sistemim – asfaltimi i rrugëve në njësinë administrative Postrisë, Dajç, Guri i Zi, Bërdicë
- Sistemim- asfaltim rruga e xhamisë Luarzë në Njësinë Administrative Velipojë
- Punimet për sistemim- asfaltimin e rrugës “Ramoshaj” në fshatin Trush të Bërdicës
- Rikonstruksion rruga “Safet Hoxha”, “Ibrahim Rugova”, “Daniel Mozali”, “Gjon Shllaku”, “Imzot Zef Simoni”, rrugë të brendshme “Shirokë”, etj.
- Rikonstruksion blloku i pallateve “Mehmet Pashë Plaku”, “Europa”, blloku i banimeve bulevardi “Zogu i I-rë”
- Përfundojnë punimet për rikonstruksionin e bllokut të pallatave “Osja i Falltores” në lagjen nr. 1 të Shkodrës.
- Përfundojnë punimet për rikualifikimin urban tek blloqe banimi "Lek Dukagjini" (tek ish-Vajguri) në qytetin e Shkodrës. Një zonë me densitet të lartë banorësh, e ka patur të nevojshme ndërhyrjen, jo vetëm për të përmirësuar lëvizshmërinë por edhe sistemimin e hapësirave.



Fig.nr.2 investimet e kryera në infrastrukturën rrugore⁴

⁴ <https://bit.ly/3pMN6aK>

Prioritet 15. *Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme.*

Në lidhje me prioritetin 15, Bashkia Shkodër për marrjen e mendimit të qytetarëve ka zhvilluar konsultimet me publikun për projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe për projektbuxhetin afatmesëm 2022 – 2024. Konsultimi me publikun është zhvilluar sipas një kalendari të caktuar: me banorët në Njësitë Administrative; me banorët në lagjet e qytetit të Shkodrës; me drejtorët e shkollave, kopshteve dhe çerdheve; me student, përfaqësues dhe pedagogë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

Gjithashtu, Bashkia Shkodër ka përdor si metodologji marrjen e mendimeve nëpërmjet një sondazhi online <https://bit.ly/3FYg919> , në mënyrë që miratimi i buxhetit të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Prioritet 18. *Zgjerim i programeve ndërgjegjësuese dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.*

Prioritet 19. *Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet, në çdo njësi administrative, të strukturave të shërbimeve sociale.*

Prioritet 20. *Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje.*

Përsa i përket fushës së dimensionit social, në lidhje me “**programme dhe shërbime mbi adresimin e dhunës në familje**”, Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2020 dhe periudhës janar-shtator 2021 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 221 raste të dhunës në familje. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

- Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme);
- shërbime komunitare (mbrojtja e fëmijëve, shërbime për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, shërbime arsimore, lëvizëse, shërbime për higijenën personale, kujdesin shëndetësor);
- shërbime të strehimit emergjent dhe të përkohshme (strehëz për situatë emergjente dhe banesa sociale).

Në varësi të nevojave specifike të rastit, ofrohen edhe shërbimet specifike për të cilat individi ka nevojë.

Problematikat e dhunës në familje u shtuan edhe më shumë gjatë periudhës së pandemisë Covid 19. Shembull i mirë i vazhdimin të ofrimit të shërbimeve ka qenë edhe këshillimi online/telefonik, si dhe hartimi i një manuali, të shkurtër dhe praktik, për t’iu ardhur në ndihmë, në veçanti të gjithë djemve dhe burrave që ndiheshin të pasigurt ndërkohë që ndodheshin në karantinim.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshme vihet re një rritje gati 2-fish e rasteve të dhunës në familje të pajisur me UMM ose UM. Për këtë arsye, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatat partnere Gruaja tek gruaja dhe Nisma/ Arsis ka rritur kapacitetet e ofrimit të shërbimit të emergjencës, duke rritur numrin e shtretërve dhe numrin e ditëve të qëndrimit në strehëz. Po në këtë kuadër është trajnuar dhe punësuar një staf i posaçëm oncall për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve emergjente, i cili funksionon 24/24, 7 në 7.

Bashkia Shkodër tashmë ka të ngritur edhe një qendër ditore që ofron shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, ku aktualisht në këtë qendër marrim shërbim 7 fëmijë.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Çdo aktivitetet sensibilizues i organizuar është publikuar në faqen e facebook të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Strehimit dhe Shëndetit Publik.⁵

Prioritet 21. *Programe ndërgjegjësuese që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje.*

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

- Buxhetimi gjinor – proces që krijon një perspektivë gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore.
- Planifikimi i shërbimeve publike, është realizuar sipas qasjes gjinore; shërbime dhe investime që i përgjigjen njëlloj të dyja gjinive; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në sigurinë e vajzave dhe grave, banore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Në territorin e bashkisë së Shkodrës, përfaqësimi i grave në politikë e vendimarrje ka pësuar një përmirësim të dukshëm; Bashkia e Shkodrës dhe Këshilli Bashkiak drejtohet nga një grua. Këshilli Bashkiak ka 51 anëtarë nga të cilët 25 gra. Stafi i Bashkisë Shkodër - 55.1% janë gra dhe 44.9% janë meshkuj.

Prioritet 22. *Zbatim me prioritet i programeve që nxisin riintegrimin dhe fuqizimin ekonomik të komunitetit romë dhe egjiptian.*

⁵ <https://bit.ly/3pLvGEY>

Qendra multifunktionale për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian.

Gjatë vitit 2020 -2021 janë ofruar shërbime sociale, integruese dhe mbështetëse për komunitetin rom dhe egjiptian ku përmendim:

- punësimin, kurse profesionale,
- identifikimi dhe regjistrimi në sistemin arsimor parashkollor dhe shkollor të të gjithë fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian,
- vizita mjekësore dhe trajtim mjekësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna,
- regjistrimi i vendbanimit në gjendjen civile të Bashkisë së Shkodrës për familjet rome të [interesuara dhe është ofruar mbështetje për çdo procedurë administrative të nevojshme për këtë proces.

Gjithashtu, Bashkia Shkodër po zbaton *programin e strehimit social* për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom ku do të përfitojnë 27 familje të këtij komuniteti.

Prioritet 25. Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve egzistuese në qytetin e Shkodrës, sipas nevojave të identifikuar.

Bashkia Shkodër menaxhon kopshtet dhe çerdhet e territorit të Bashkisë, përkatësisht 55 kopshte dhe 7 çerdhe, duke filluar nga mbështetja e personelit tek mirëmbajtja dhe menaxhimi i godinave. Gjatë këtij viti janë kryer investime sipas nevojave të godinave duke dhënë një impakt të qënësishëm në përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe çerdheve.

- Rikonstruksion i kopështit në fshatin Kuç
- Rikonstruksion i kopështit “Bep Tusha”
- Rikonstruksion, shtim kapaciteti i kopështit “1 Qershori”



Fig.nr.3 Kopshti 1 Qershori⁶

⁶ <https://bit.ly/3GAUBZ5>

Nga takimet me qytetarët dhe intervistat e strukturuar rezultojn se :

- Pavarësisht punës pozitive që ka kryer Bashkia Shkodër përgjat kësaj periudhe, qytetarët shprehin se **shërbimet publike** në tërësi duhet të përmirësohen.
- **Transporti publik** vazhdon të jetë akoma një shqetësim prandaj kërkohet të organizohet në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe studentëve si në qytet dhe njësitë administrative.
- **Shërbimi i pastrimit** ka nevojë sërish për më shumë ndërhyrje duke rritur frekuencën e pastrimit në zonat informale dhe duke shtuar numrin e kontinierëve.
- Mungesa e investimeve për zgjerimin e **hapësirave të gjelbërta** në qytet dhe në zonat mes blloqeve të banimit.
- Vijim i investimeve në **infrastrukturën rrugore** si në lagjet e qytetit ashtu edhe në njësitë administrative si dhe të rishikohet një sistem pikëzimi në prioritizimin e investimeve.
- Vëmendje e shtuar për **infrastrukturën arsimore**, ku në disa njësi administrative si Postribë apo Guri i Zi duhet të ndahen ose të zgjerohen ambientet e kopshtit dhe të shkollave.
- Të shikohet me prioritet siguria rrugore e shkollave që kanë dalje direkte në rrugë duke e plotësuar me sinjalistikën e nevojshme.
- Ngritja e terreneve sportive për të rinjtë si në qytet dhe në njësitë administrative.
- Në njësitë administrative kërkohet bashkërendim i punës komunitet – bashki – bord kullimi në lidhje me hapjen, pastrimin, dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese.

Gjatë këtij viti të monitorimit, për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021, janë vënë re hapa pozitiv në realizimin e prioriteteve nga ana e Bashkisë Shkodër. Në krahasim me vitin e parë të monitorimit, këtë vit ka patur ndërhyrje në disa fusha të rëndësishme. Nga vëzhgimet e kryera dhe intervistat e strukturuar rezultojn se disa nga prioritetet janë pjesërisht apo plotësisht të përmbushura si më poshtë:

- **Mirëmbajtja e shkollave egzistuese dhe plotësimi me mjete didaktike**, prioritet i cili është përmbushur deri në masën 54%.

- *Përmirësim i cilësisë së pastrimit dhe shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave në qytetin e Shkodrës dhe njësitë administrative*, prioritet i përbushur deri në masën 40%.
- *Vijimi i investimeve dhe ndërhyrjeve që përmirësojnë infrastrukturën rrugore*, është prioritet i cili është përbushur deri në masën 60% , ku në vitin e parë të monitorimit ka qenë i pa adresuar.
- Përsa i përket prioritetit, *bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimmarrjet më të rëndësishme*, është përbushur në masën 75% pasi ka realizuar konsultimin e buxhetit dhe dëgjesat publike.
- *Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje*, prioritet i cili është adresuar deri në masën 62%.
- *Mundësitë e komunitetit për ta marrë informacionin dhe që mundësojnë transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak*, prioritet i adresuar deri në masën 85%, ku informacioni ndahet rregullisht në rrjetet sociale.
- *Krijimi i incentivave mbështetëse nëpërmjet programeve të specializuara për mbështetje financiare për startup-et rinore*, prioritet i përbushur deri në masën 50%.
- *Organizimi i transportit publik*, një prioritet i cili nuk është adresuar.

Rekomandime

- Bashkia Shkodër duhet të ndërtoj mekanizma të qëndrueshëm edhe efektiv për komunikimin dhe konsultimin me qytetarët jo vetëm sipas periudhave kur realizohet procesi i buxhetimit por edhe gjatë zbatimit të buxhetit.
- Organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti duhet të përfshihen në proceset vendimmarrëse jo vetëm si dëgjues por edhe si pjesë të grupeve të punës në funksionin monitorues dhe këshillues.
- Konsiderojmë të nevojshëm fuqizimin e rolit të ndërlidhësit komunitare ku shqetësimet dhe prioritetet e komunitetave të identifikohen në baza të përhershme.
- Grupet qytetare, grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile si dhe rinia studentore duhet që të afrohen jo thjesht nëpërmjet dhënies së ideve por edhe prezantimit të projekteve, strategjive apo ndërhyrjeve afatshkurtëra apo afatmesme për zgjidhjen e çështjeve të caktuara në komunitet.
- Bashkia duhet që të shoh mundësi me mbështetje nga buxheti i saj për nxitjen e iniciativave që forcojnë rolin e komunitetit në vendimmarrje duke ndikuar drejtpërsëdrejti në një qeverisje të mirë.

Referenca

1. Faqja web Bashkia Shkodër <https://www.bashkiashkoder.gov.al/>
2. Rrjeti Social Facebook Këshilli Bashkiak Shkodër <https://bit.ly/3IuiMdg>
3. Rrjeti social Facebook Bashkia Shkodër <https://www.facebook.com/bashkiashkodres>
4. Faqja zyrtare e Kryetares së Bashkisë Shkodër <https://www.facebook.com/ademi.voltana>
5. <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-shkoder/>
6. <https://bit.ly/3GAUBZ5>
7. <https://bit.ly/3lPf4kS>
8. <https://bit.ly/3EGPQfN>
9. <https://bit.ly/3ybvBEC>
10. <https://bit.ly/3pMN6aK>